


Prodhimi i Brendshëm Bruto sipas Rajoneve Statistike në Shqipëri, 2020

Tiranë, Maj 20, 2022: Në vitin 2020, sipas rajoneve statistikore në nivel 1 (Republika e Shqipërisë), PBB me çmime korrente u vlerësua 1.644.077 milionë Lekë, duke shënuar një rënie në terma realë me -3,48 %, krahasuar me vitin 2019.

Kontributin më të madh në rritjen ekonomike për vitin 2020, e ka dhënë Qarku Elbasan me +0,02 pikë përqindje, pasuar nga Qarku Berat me +0,01 pikë përqindje. Të gjithë Qarqet e tjera kanë kontribuar negativisht. Kontributin më të ulët në rritjen ekonomike e ka dhënë Qarku Tiranë me -1,40 pikë përqindje, i pasuar nga Qarku Durrës me një kontribut prej -0,59 pikë përqindje dhe Qarku Fier me një kontribut prej -0,58 pikë përqindje.

Fig.1 Kontributi i Qarqeve në rritjen ekonomike



*2020 Të dhëna gjysmë-finale

Për publikim 20/05/2022

Sipas rajoneve statistikore në nivel 2, PBB me çmime korente në rajonin Veri u vlerësua 372,5 miliardë Lekë ose 22,66 % ndaj PBB në nivel vendi. Krahasuar me vitin 2019, PBB për këtë rajon shënoi një rënie në terma realë me -5,25 %.

PBB me çmime korente në rajonin Qendër, u vlerësua 818,8 miliardë Lekë ose 49,80 % ndaj PBB në nivel vendi. Krahasuar me vitin 2019, PBB për këtë rajon shënoi një rënie me -2,80 % në terma reale.

PBB me çmime korente në rajonin Jug u vlerësua 452,8 miliardë Lekë ose 27,54 % ndaj PBB në nivel vendi. Krahasuar me vitin 2019 në rajonin Jug, PBB në terma reale shënoi një rënie prej -3,23 %.

Sipas rajoneve statistikore në nivel 3 (Qark), rritjen më të lartë të PBB-së në terma realë e shënoi Qarku Berat me 0,33 %, i ndjekur nga Qarku Elbasan me 0,30 %.

Rritja reale e PBB-së sipas rajoneve statistikore u ngadalësua në të gjithë Qarqet e tjera, ku rënien me të lartë shënoi Qarku Lezhë me 6,28 %, Qarku Dibër me 6,14 % dhe Qarku Durrës me 5,83 % të PBB-së.

Tab. 1 PBB sipas rajoneve statistikore


Kodi	Niveli Statistikor 2 / 3	PBB çmime korente (milion Lekë) 2019	PBB çmime korente (milion Lekë) 2020*	Rritja Reale e PBB-së 2020*/2019	Kontributi ndaj rritjes Reale 2020*/2019	Struktura ndaj PBB-së 2019	Struktura ndaj PBB-së 2020*
AL	Republika e Shqipërisë	1.691.903	1.644.077	-3,48	-3,48	100,00	100,00
AL01	Veri	389.330	372.517	-5,25	-1,21	23,01	22,66
AL011	Dibër	51.112	48.267	-6,14	-0,19	3,02	2,94
AL012	Durrës	171.576	164.087	-5,83	-0,59	10,14	9,98
AL013	Kukës	27.362	27.309	-0,10	-0,002	1,62	1,66
AL014	Lezhë	53.262	50.203	-6,28	-0,20	3,15	3,05
AL015	Shkodër	86.017	82.652	-4,55	-0,23	5,08	5,03
AL02	Qendër	835.124	818.802	-2,80	-1,38	49,36	49,80
AL021	Elbasan	111.830	112.244	0,30	0,02	6,61	6,83
AL022	Tiranë	723.294	706.559	-3,28	-1,40	42,75	42,98
AL03	Jug	467.450	452.758	-3,23	-0,89	27,63	27,54
AL031	Berat	57.883	57.217	0,33	0,01	3,42	3,48
AL032	Fier	188.442	178.185	-5,24	-0,58	11,14	10,84
AL033	Gjirokastër	37.087	36.046	-3,59	-0,08	2,19	2,19
AL034	Korçë	90.725	88.307	-3,42	-0,18	5,36	5,37
AL035	Vlorë	93.312	93.003	-1,05	-0,06	5,52	5,66

*2020 Të dhëna gjysmë-finale

PBB për frymë sipas niveleve statistikore

Në vitin 2020, niveli i PBB-së për frymë në rajonin statistikor nivel 1 (Republika e Shqipërisë), arriti në 579 mijë Lekë. Krahasuar me vitin 2019 PBB për frymë në terma nominale shënoi një rënie me -2,27 %.

Fig. 2 PBB për frymë sipas rajoneve statistikore nivel 3, viti 2020* (000/Lekë)



* 2020 Të dhëna gjysmë-finale

Sipas rajoneve statistikore në nivel 2, në rajonin statistikor Veri, PBB për frymë u vlerësua 465 mijë Lekë, duke shënuar një rënie në terma nominale me -3,37 %, krahasuar me vitin 2019. PBB për frymë e këtij rajoni rezultoi -19,76 % nën mesataren e vendit.

Në rajonin statistikor Qendër, PBB për frymë u vlerësua 695 mijë Lekë, duke shënuar një rënie në terma nominale me -2,30 %, krahasuar me vitin 2019. PBB për frymë e këtij rajoni rezultoi 20,05 % mbi mesataren e vendit.

Në rajonin statistikor Jug, PBB për frymë u vlerësua 527 mijë Lekë, duke shënuar një rënie në terma nominale me -1,72 %, krahasuar me vitin 2019. PBB për frymë e këtij rajoni rezultoi -9,04 % nën mesataren e vendit.

Niveli më i lartë i PBB-së për frymë sipas rajoneve statistikore në nivel 3 (Qark), në vitin 2020, ishte në Qarkun Tiranë, me 777 mijë Lekë dhe shënoi një rënie në terma nominale me -3,23 %, krahasuar me vitin 2019. PBB për frymë e këtij qarku rezultoi 34,14 % mbi mesataren e vendit. Më pas renditet Qarku Fier me 619 mijë Lekë, duke shënuar një rënie në terma nominale me -4,01 %, ndaj vitit 2019. PBB për frymë e këtij qarku rezultoi 6,81% mbi mesataren e vendit.

Niveli më i ulët i PBB-së për frymë sipas rajoneve statistikore në nivel 3 (Qark) në vitin 2020, u vlerësua në Qarkun Kukës me 365 mijë Lekë duke shënuar një rritje në terma nominale me + 1,27 %, krahasuar me vitin 2019. PBB për frymë e këtij qarku rezultoi -37,07 % nën mesataren e vendit. Më tej, me PBB-në

për frymë më të ulët vijon Qarku Lezhë me 413 mijë Lekë duke shënuar një rënie në terma nominale -3,99 % ndaj vitit 2019. PBB për frymë e këtij qarku rezultoi -28,79 % nën mesataren e vendit.

Tab. 2 PBB për frymë sipas rajoneve statistikore

Kodi	Niveli Statistikor 2/3	PBB për frymë (Lekë)		Rritja e PBB-së për frymë me çmime korente (%)	Indeksi ndaj PBB-së (%)	Indeksi ndaj PBB-së (%)
		2019	2020*	2020*/2019	AI=100	AI=100
AL	Republika e Shqipërisë	592.779	579.339	-2,27	100,00	100,00
AL01	Veri	481.109	464.876	-3,37	81,16	80,24
AL011	Dibër	435.332	420.554	-3,39	73,44	72,59
AL012	Durrës	590.809	563.170	-4,68	99,67	97,21
AL013	Kukës	359.970	364.558	1,27	60,73	62,93
AL014	Lezhë	429.699	412.546	-3,99	72,49	71,21
AL015	Shkodër	426.986	416.186	-2,53	72,03	71,84
AL02	Qendër	711.842	695.472	-2,30	120,09	120,05
AL021	Elbasan	410.346	418.570	2,00	69,22	72,25
AL022	Tiranë	803.070	777.144	-3,23	135,48	134,14
AL03	Jug	536.208	526.959	-1,72	90,46	90,96
AL031	Berat	468.395	473.936	1,18	79,02	81,81
AL032	Fier	644.650	618.812	-4,01	108,75	106,81
AL033	Gjirokastrë	614.081	614.013	-0,01	103,59	105,98
AL034	Korçë	439.636	433.916	-1,30	74,17	74,90
AL035	Vlorë	493.411	493.910	0,10	83,24	85,25

* 2020 Të dhëna gjysmë-finale

Standardi i Fuqisë Blerëse

PBB e Republikës së Shqipërisë e shprehur në Standardin e Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Standard - PPS) në vitin 2020 është 25.851 milionë PPS.

PBB për frymë në PPS për vitin 2020 për Republikën e Shqipërisë është 30,5 % e mesatares së Bashkimit Evropian BE_27 = 100 (shih shënime metodologjike). Sipas rajoneve statistikore në nivel 2, në rajonin Qendër, PBB për frymë në PPS për vitin 2020 ishte 36,6 %, në rajonin Veri 24,4 % dhe në rajonin Jug 27,7 %.

Tab.3 PBB për frymë në PPS (BE_27=100)

Kodi	Rajonet Statistikore	PBB për frymë në PPS (BE_27=100), viti 2020
	Republika e Shqipërisë	30,5
	Rajone Statistikore Nivel 2	
AL01	Veri	24,4
AL02	Qendër	36,6
AL03	Jug	27,7

Tab. 4 Struktura e Vlerës së Shtuar Bruto sipas degëve të ekonomisë dhe rajoneve statistikore (Dega = 100 %), viti 2020*

Kodi	Nivelet Statistikore 2/3	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	Industria nxjerrëse; Përpunuese; Energjia; Ujë	Ndërtimi	Tregtia; Transport; Hotele	Informacioni dhe komunikacioni	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	Aktivitete të pasurive të paluajtshme	Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike;	Adm. Publike; Arsimi; Shëndetësia etj	Arte, argëtim; çlodhje etj	VSHB me çmime korente
AL	Republika e Shqipërisë	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0
AL01	Veri	27,1	28,2	20,0	21,5	12,7	27,5	24,8	13,4	20,6	16,6	22,7
AL011	Dibër	5,9	4,4	1,3	1,0	1,5	4,9	1,5	1,1	2,8	0,9	2,9
AL012	Durrës	7,2	14,5	9,0	13,4	5,8	10,6	14,2	8,5	6,7	6,6	10,0
AL013	Kukës	2,8	1,5	1,8	0,8	1,1	1,6	1,0	0,3	2,3	0,5	1,7
AL014	Lezhë	4,3	3,0	3,1	2,4	1,7	5,9	3,0	1,1	3,1	2,3	3,1
AL015	Shkodër	6,9	4,8	4,9	3,9	2,7	4,5	5,1	2,4	5,6	6,2	5,0
AL02	Qendër	20,1	45,8	58,4	57,6	74,5	47,5	53,4	76,7	58,1	71,1	49,8
AL021	Elbasan	12,4	8,8	4,3	4,3	3,0	4,9	5,4	2,2	6,4	4,1	6,8
AL022	Tiranë	7,7	37,0	54,0	53,3	71,5	42,6	48,0	74,5	51,7	67,1	43,0
AL03	Jug	52,8	26,0	21,6	20,9	12,8	24,9	21,8	9,9	21,3	12,2	27,5
AL031	Berat	7,9	2,5	2,1	2,3	1,9	4,2	1,8	0,8	2,9	1,0	3,5
AL032	Fier	23,8	12,7	6,8	7,4	3,4	7,5	6,7	3,3	6,0	4,1	10,8
AL033	Gjirokastrë	2,9	1,9	1,7	2,3	1,5	3,1	1,5	1,0	2,8	1,2	2,2
AL034	Korçë	10,2	4,0	4,4	4,0	2,9	4,7	4,3	1,5	5,2	3,2	5,4
AL035	Vlorë	7,9	5,0	6,6	4,9	3,1	5,4	7,6	3,2	4,4	2,7	5,7

*2020 Të dhëna gjysmë-finale


Tab. 5 Struktura e Vlerës së Shtuar Bruto sipas rajoneve statistikore dhe degëve të ekonomisë (Rajoni = 100 %), viti 2020*

Kodi	Nivelet Statistikore 2/3	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	Industria nxjerrëse; Përpunuese; Energjia; Ujë	Ndërtimi	Tregtia; Transport; Hotele	Informacioni dhe komunikacioni	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	Aktivitete të pasurive të paluajtshme	Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike;	Adm. Publike; Arsimi; Shëndetësia etj	Arte, argëtim; çlodhje etj	VSHB me çmime korente
AL	Republika e Shqipërisë	22,0	12,6	10,3	18,4	3,5	2,4	7,1	7,3	14,0	2,5	100,0
AL01	Veri	26,3	15,6	9,1	17,5	1,9	2,9	7,7	4,3	12,7	1,9	100,0
AL011	Dibër	44,0	19,0	4,6	6,3	1,7	4,0	3,5	2,7	13,3	0,8	100,0
AL012	Durrës	15,8	18,2	9,2	24,8	2,0	2,5	10,1	6,2	9,4	1,7	100,0
AL013	Kukës	37,7	11,4	11,0	9,2	2,3	2,4	4,2	1,4	19,6	0,8	100,0
AL014	Lezhë	30,8	12,1	10,3	14,4	1,9	4,6	7,0	2,6	14,4	1,9	100,0
AL015	Shkodër	30,3	11,9	10,0	14,3	1,9	2,1	7,3	3,5	15,6	3,1	100,0
AL02	Qendër	8,9	11,6	12,0	21,3	5,2	2,3	7,6	11,2	16,4	3,6	100,0
AL021	Elbasan	39,9	16,2	6,5	11,6	1,5	1,7	5,6	2,4	13,2	1,5	100,0
AL022	Tiranë	3,9	10,8	12,9	22,9	5,8	2,4	7,9	12,6	16,9	4,0	100,0
AL03	Jug	42,1	11,9	8,1	14,0	1,6	2,2	5,6	2,6	10,8	1,1	100,0
AL031	Berat	50,2	8,9	6,1	12,3	1,9	2,9	3,6	1,7	11,7	0,8	100,0
AL032	Fier	48,3	14,7	6,4	12,5	1,1	1,6	4,4	2,2	7,7	1,0	100,0
AL033	Gjirokastrë	29,1	10,6	7,9	19,3	2,4	3,3	4,8	3,4	17,7	1,3	100,0
AL034	Korçë	41,7	9,4	8,5	13,6	1,9	2,1	5,7	2,0	13,6	1,5	100,0
AL035	Vlorë	30,8	11,1	12,1	16,1	1,9	2,3	9,5	4,1	11,0	1,2	100,0

*2020 Të dhëna gjysmë-finale


Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>

Fig.3 PBB për frymë sipas Qarqeve



NUTS 2
 Prefecture

PBB për frymë në mijë Lekë



* Vlerësimet për vitin 2020 bazohen në të dhënat gjysmëfinale


** Shqipëria ndahet në 3 rajone statistikore niveli 2 dhe 12 rajone statistikore niveli 3, që i korrespondojnë qarqeve ekzistuese, sipas Vendimit të KM nr.1037 date 15.12.2010, "Mbi Implementimin e Nomenklaturës NUTS" duke ndjekur nomenklaturën mbi Njësitë Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian

Burimi: Përlllogaritjet vjetore të INSTAT

Burimi i kufijve administrativë:

Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)


Fig. 4 PBB me çmime korente sipas Qarqeve



NUTS 2

Qark

PBB në miliardë Lekë



* Vlerësimet për vitin 2020 bazohen në të dhënat gjysmëfinale

** Shqipëria ndahet në 3 rajone statistikore niveli 2 dhe 12 rajone statistikore niveli 3, që i korrespondojnë qarqeve ekzistuese, sipas Vendimit të KM nr.1037 date 15.12.2010, "Mbi Implementimin e Nomenklaturës NUTS" duke ndjekur nomenklaturën mbi Njësitë Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian

Burimi: Përlogaritjet vjetore të INSTAT

Burimi i kufijve administrativë:

Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)

Metodologjia

Ky publikim paraqet rezultatet e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) për vitin 2020 në Republikën e Shqipërisë sipas rajoneve statistikore në nivel 1, 2 dhe 3, të përcaktuara sipas Nomenklaturës së Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian, si dhe degëve të ekonomisë sipas nomenklaturës NVE Rev 2.

Llogaritë Kombëtare Rajonale bazohen në metodologjinë ESA 2010, kryesisht te Kapitulli 13, duke marrë si bazë vlerësimet më të fundit të Llogarive Kombëtare Vjetore të publikuara më 30 Prill 2022, në mënyrë që të ruhet konsistenca e këtyre treguesve.

Informacioni më i detajuar rreth Llogarive Kombëtare Rajonale (2015-2020) mbi treguesit rajonalë mund ta gjeni në linkun më poshtë.

<http://instat.gov.al/al/temat/ekonomi-dhe-financ%C3%AB/llogarit%C3%AB-rajonale-n%C3%AB-shqip%C3%ABri/#tab2>

Metodologji dhe klasifikime

Llogaritjet e treguesve rajonalë mbështeten metodologjikisht në konceptet bazë të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010) dhe të Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA 2008). Të dyja këto metodologji janë përditësimet më të fundit të ESA 1995 dhe SNA 1993. Sistemi evropian i llogarive kombëtare dhe rajonale është korniza për matjen e aktiviteteve ekonomike dhe financiare të një sistemi ekonomik, komponentëve të tij dhe lidhjeve midis tyre në një periudhë kohe të dhënë (zakonisht një vit). Transaksionet e kryera nga agjentët ekonomikë në lidhjet e tyre me njësitë e tjera rezidente ose jo rezidente në territorin ekonomik janë objekt i matjeve në llogaritë kombëtare rajonale. Përditësimet e klasifikimeve bëhen që treguesit ekonomikë rajonalë të jenë më të dobishëm për përdoruesit, në mënyrë që të pasqyrojnë zhvillimet ekonomike dhe të përmirësojnë krahasueshmërinë e të dhënave midis rajoneve dhe vendeve anëtare të BE-së bazuar në Nomenklaturën e Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Evropian.

Parimi i Rezidencës

Parimi kryesor për vlerësimin e VSHB-së në Llogaritë Rajonale është “Parimi i rezidencës” sipas të cilit Vlera e Shtuar Bruto (VSHB) shpërndahet sipas rajonve ku njësitë prodhuese janë rezidente, pra aty ku ajo krijohet.

Ndryshimet në vlerësimet e Llogarive Kombëtare Vjetore kanë reflektuar dhe në Llogaritë Rajonale si në të dhëna dhe në metodologji. INSTAT ka bërë një ndryshim cilësor në zhvillimin e metodave në vlerësimin e VSHB-së rajonale për ndarjen e veprimtarive ekonomike të ndërmarrjeve dhe institucioneve që ushtrojnë veprimtarinë kryesore në një apo më shumë rajone.

Në lidhje me metodologjinë e përdorur konsultohuni me materialin: “Metodologjia e Llogarive Rajonale në Shqipëri” në adresën e mëposhtëme:

<http://www.instat.gov.al/media/4638/part-e-regional-accounts-albania.pdf>

Klasifikimet e përdorura në Llogaritë Kombëtare Rajonale janë:

- Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike REV.2 (NVE Rev.2).
- Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat (NUTS).

Nomenklatura e njësive territoriale për statistikat (NUTS) është një klasifikim i përbashkët, në bazë të të cilit mbliidhen dhe përpunohen, statistikat rajonale evropiane.

Standarti i Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Standard-PPS) është një njësi monedhe artificiale që merr parasysh ndryshimet në nivelet kombëtare të çmimeve. Kjo njësi lejon krahasime të mirëfillta të vëllimit të treguesve ekonomikë për vendet. Agregatet e shprehura në PPS dalin duke pjesëtuar agregatet (treguesit) vlerësuar me çmimet aktuale dhe me monedhën kombëtare përkatësisht me Paritetin e Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Parity-PPP). Indeksi i volumit i PBB-së për frymë i shprehur në Standartin e Fuqisë Blerëse (PPS - Purchasing Power Standards) është dhënë në raport me mesataren e Bashkimit Evropian (BE27=100).

Ju lutem vini re se indeksi i shprehur në PPS përdoret për krahasime midis vendeve sesa për krahasime në termat e serive kohore. Për informacione të mëtejshme mbi koeficientët e PPS ndiqni adresën e mëposhtme:

https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/prc_ppp_ind/default/table?lang=en.